

**LIGJ**  
**Nr. 51/2013**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 10 107, DATË 30.3.2009**  
**“PËR KUJDESIN SHËNDETËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 10 107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

**Neni 1**

Në të gjithë ligjin, emërtimi “Inspektorati Shtetëror i Shëndetësisë” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit”.

**Neni 2**

Në nenin 23 pika 3, fjalët “dhe mbikëqyrjen e jashtme” hiqen.

**Neni 3**

Neni 25 ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 25**  
**Inspektimi**

Inspektimi i respektimit të kërkesave ligjore, të parashikuara në këtë ligj, i institucioneve të kujdesit shëndetësor kryhet nga inspektorati që mbulon fushën e shëndetit në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

**Neni 4**

Në nenin 26, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Institucionet shëndetësore i nënshtrohen procesit të akreditimit përmes Qendrës Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit, në mënyrë periodike, për të vlerësuar shkallën e plotësisë nga ana e tyre të standardeve të paracaktuara dhe të publikuara nga Ministria e Shëndetësisë.”.

**Neni 5**

Në nenin 38 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) Shkelja e nenit 27 të këtij ligji nga personat fizikë ose juridikë, publikë ose privatë, që ofrojnë kujdes shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, dënohet me gjobë 500 000 lekë dhe, në rast përsëritjeje, me 5-fishin e gjobës dhe denoncim në organet kompetente.”.



2. Pas shkronjës “ç” shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:  
“Masa e gjobës është dënim kryesor, ndërsa masa e heqjes së licencës është dënim plotësues.”.

Neni 6

Neni 39 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 39  
**Ankimi dhe ekzekutimi**

1. Ankimi ndaj vendimit të inspektoratit bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.
2. Ekzekutimi i vendimeve bëhet sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 7

**Dispozitë kalimtare**

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8010, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

**LIGJ  
Nr. 52/2013**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 138, DATË 11.5.2009 “PËR SHËNDETIN  
PUBLIK”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 10 138, datë 11.5.2009 “Për shëndetin publik”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 26 ndryshohet si më poshtë: